

Si të dalloni dhe kuptoni përmbajtje të gjeneruara me AI ose të modifikuara digjitalisht

Modelet e AI-së, të aksesueshme dhe të lehta për t'u përdorur, mund t'i ndihmojnë njerëzit të mësojnë dhe të krijojnë përmbajtje, por **edhe të zmadhojnë rreziqet që shkaktjnë dezinformimi dhe keqinformimi** për shoqëritë e hapura dhe debatin demokratik. Parandalimi i mbushjes së hapësirave tona të përbashkëta të informacionit me dezinformim dhe keqinformim të gjeneruar dhe modifikuar në mënyrë digjitale nga AI është i rëndësishëm.

Teknologjia e re, si nismat për zbulimin e origjinës së përmbajtjes dhe softuerët e zbulimit, konsiderohen si pjesë e zgjidhjes. **Megjithatë, zgjidhjet teknologjike janë larg të qenit të përsosura dhe puna e verifikuesve të pavarur të fakteve është e domosdoshme për t'i siguruar shoqërisë fakte të verifikuara.**

Ndaj, këtu kemi një përmbledhje të shpejtë të asaj çka bëjnë verifikuesit profesionistë dhe të pavarur të fakteve për të identifikuar dhe demaskuar keqinformimet dhe dezinformimet e gjeneruara nga AI, si dhe çfarë mund të mësoni prej tyre.

Përmbajtjet e gjeneruara me AI janë në rritje

Sot, keqinformimi dhe dezinformimi i gjeneruar nga AI përbëjnë një përqindje të vogël të të gjitha rasteve të hetuara nga verifikuesit e pavarur dhe profesionistë të fakteve. Përmbajtjet e modifikuara në mënyrë digjitale mbizotërojnë më shumë në punën e verifikuesve të fakteve.

Megjithatë, në një sondazh të brendshëm të anëtarëve të EFCSN, **pjesa më e madhe e verifikuesve të fakteve ranë dakord se përmbajtja e gjeneruar nga AI dhe e modifikuar në mënyrë digjitale** do të bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në të ardhmen. Edhe [shembujt e fundit](#) në kontekstin e zgjedhjeve evropiane e mbështesin këtë parashikim.

TË KUPTOHET: *E ndryshuar digjitalisht* i referohet çfarëdolloj përmbajtjeje që ndryshohet mjaftueshëm për të manipuluar ose ndryshuar mesazhin origjinal që transmeton, duke përfshirë ndryshimet përmes mjeteve AI. Këtu nuk përfshihen ndryshimet për qartësi ose për cilësi

Gjeneruar me AI i referohet çdo forme përmbajtjeje që krijohet nga sisteme të inteligjencës artificiale.



Teknologjia zhvillohet shpejt, por ne nuk mund të mbështetemi vetëm tek ajo.

Ekspertët e inteligjencës artificiale AI dhe verifikuesit profesionistë të fakteve bien dakord se: **vetëm mjetet e zbulimit të AI-së nuk janë të mjaftueshme për të zbuluar ose përgënjeshtuar përmbajtje të krijuara me AI ose të ndryshuara digjitalisht.**

Përpara përdorimit të mjeteve të zbulimit, ekspertët rekomandojnë familjarizimin me gjeneruesit dhe detektorët e përmbajtjes së AI-së. Me kuptimin e mënyrës së trajnimit të modeleve dhe me njohuri bazike në statistikë, verifikuesit e fakteve mund të dallojnë pikat e forta dhe të dobëta të një mjeti dhe gjasat e tij të suksesit. **Megjithatë, mjetet mund të jenë një pikë e dobishme nisjeje.**

Nismat për **originën e përmbajtjes**, si Specifikimet C2PA, mund të ndihmojnë në verifikimin e burimit dhe të historikut të përmbajtjes, por vendosja e shenjave dalluese dhe verifikimi nuk janë të plotësisht të besueshme.

Si ndikon dezinformimi përmes AI tek njerëzit

"Sa herë që reagoni, sipas instinkteve tuaja, atëherë reagimi kalon përtej reflektimit tuaj".

- Christine Dugoin*

PSIKOLOGJIA: Nismat për ushtrimin e ndikimit shpesh janë të dizajnuara për të përfituar nga paragjykimet psikologjike.

Njohja e paragjyqimeve vetjake dhe të audiencës, mund të ndihmojë në luftën kundër dezinformimit.

- **QËLLIMET:** Përse një aktor i keq mund të mbështetet tek AI për të krijuar ose përhapur dezinformim? Cili është ndikimi që kanë për qëllim të arrijnë në botën reale?
- →Zgjerimi i ndikimit të tyre në një vend ose komunitet tjetër?
- →Shmangia e zbulimit ose shpërqendrimi i verifikuesve të fakteve duke gjeneruar variante të ndryshme pretendimesh të ngjashme?
- →Ndikimi i mendimeve ose besimeve duke krijuar besueshmëri përmes rrjeteve të llogarive jo origjinale?

* Christine Dugoin është studiuese e ndikimit informativ në La Sorbonne

Për hedhjen poshtë të pretendimeve nevojitet një qasje shumë dimensionale dhe njohja e nuancave

Nëse mjetet e zbulimit nuk funksionojnë, çfarë duhet të bëjmë? Është e rëndësishme të kuptojmë kontekstin e një pretendimi aq sa dhe përmbajtjen e tij. Verifikuesit profesionistë të fakteve janë ekspertë të aftësive të nevojshme investigative. Ja disa këshilla.

Mjetet e zbulimit nuk do të funksionojnë kurrë 100% -dhe as nuk e pres kurrë një gjë të tillë."
- Henk van Ess**



SHQYRTO BURIMIN: A mund të konfirmoni identitetin e tyre? Për çfarë flasin dhe çfarë shpërndajnë ata? Kush ndërvepron me përmbajtjen e tyre? Çfarë ndikimi mund të ketë përmbajtja e tyre te lexuesit?



KRIJO BESUESHMËRI: Vërtetoni informacionet në mënyrë të pavarur përmes burimeve të besueshme si ekspertët me përvojë praktike në fushën përkatëse. A është logjike ajo çka është prezantuar, bazuar në njohuritë tuaja?



Përdorni metodat e analizës **FORENSIKE MEDIAKTIKE** për të pasuruar investigimin tradicional dhe kërkimin dokumentues. Disa nga këto teknika përfshijnë: nxjerrjen e të dhënave, vendndodhjen gjeografike, njohjen biometrike, analizën e modeleve dhe të tjera.



MËSO DHE PËRSHTATU: Krijuesit e dezinformimit me AI janë gjithmonë në përshtatje e sipër. Përshtasni qasjen tuaj sipas panoramës së ndryshuar.

NDAJ PUNËN TËNDE

Bashkë me pretendimin e hedhur poshtë, ekspertët rekomandojnë paraqitjen e një analize transparente dhe lidhjet e burimeve të përdorura. Kjo mund t'i ndihmojë lexuesit të ndjekin investigimin dhe të kuptojnë nuancat e narrativës. Në disa raste, investigimi është më i rëndësishëm sesa gjenerimi ose jo i përmbajtjes me AI.

** Henk van Ess është ekspert në fushën e OSINT dhe për teknikat e kontrollit të fakteve

EFSN Udhëzues i shpejtë referimi: Çfarë duhet të bësh, të mos bësh, dhe disa indikatorë

Më poshtë jepen disa indikatorë që mund t'ju tregojnë se pjesë të caktuara të përmbajtjes janë krijuar me AI ose janë ndryshuar në mënyrë digjitale. Bashkë me këshillat e tjera të përmendura në këtë udhëzues (konteksti, teknikat investigative dhe mjetet e zbulimit), ato mund t'ju ndihmojnë të kuptoni të vërtetën që fshihet pas asaj çka shihni.

Teksti

- Shpesh (por jo gjithmonë) **ka gramatikë më të mirë** se ajo e një njeriu.
- Ka tendencë të përdorë **gjuhë tejet formale ose të strukturuar**, veçanërisht në kontekstin e mediave sociale.
- **Përdorimi i tepërt i ndajfoljeve dhe mbiemrave.**
- Mungesa e emocioneve njerëzore, humorit, sarkazmës dhe shprehjeve idiomatike.
- Mund t'i **mungojnë detaje specifike** (emra, data, vende) ose ide origjinale.
- Më e rëndësishmja: a janë të sakta faktet e përmendura në tekst?

Video

- Mos përdorni detektor imazhesh të gjeneruar me AI për imazhe fikse të marra nga një video.
- Shihni **shprehjet e fytyrës dhe lëvizjet**, si përpëlitja e syve, dhe nëse lëvizja e gojës përputhet me audion.
- Mund të kenë **kalime të menjëhershme ose prerje të shpejta.**

Audio

- **Krahasoni audion e dyshimtë me mostrën autentike** duke përdorur mjetet që mund të zbulojnë dallimet në modelet e të folurit, frymëmarrjes, intonacionit...
- Nëse përdorni detektorë, shmangni mostrat me cilësi të ulët audioje me zhurmë statike dhe në sfond.
- Mund të kenë **modele jo natyrale ose mekanike të foluri**, mungesë pauzash ose frymëmarrjeje natyrale.

Imazhe

- Shihni për zona **me detaje të pazakonta**: lëkurë të përsosur, sfond të zbehur, bukuri ose dritë të pazakontë dhe gjëra të tjera çuditshme si gishta shtesë.
- **Shihni për shenja dalluese** që vendosen nga gjeneruesit e zakonshëm të imazheve.
- Kushtojini vëmendje detajeve të shfaqura: a janë logjike? A janë të përshtatshme?
- Në rastet kur përdorni detektorë, **zgjidhni një version me rezolucion të lartë ose një version të ngarkuar më herët të një imazhi, në vend të atyre që janë ndarë dhe rindarë disa herë**